



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm  
Odeljenje za Privreda, Razvoj i Turizam  
Department of Economy, Development and Tourism

REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

## THIRRJE PËR APLIKIM

-III. Nr. I prot 2735 Më 03.09.2019  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

### 1. Skema e grandeve "Zhvillimi i ndërmarrësisë në komunën e Rahovecit"

Komuna e Rahovecit me lansimin e skemës së grandeve përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrësisë do të ndihmojë në plotësimin e nevojave të të berit biznes. Kjo skemë e grandeve do të mundësojë që projektet cilësore biznesore të implementohen dhe zhvillohen më tej, duke krijuar kështu vende të reja pune. Këto vende të reja të punës do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese që veprojnë në sektorët me potencial më të madhe për zhvillim.

### 2. Synimet e Thirrjes për Projekt Propozim

Synimi i përgjithshëm i thirrjes është zhvillim socio-ekonomik komunal i balancuar përmes përkrahjes së zhvillimit të bizneseve ne sektorin e zhvillimit ekonomik në komunën e Rahovecit.

Synimet specifike të kësaj ThPP janë:

- Krijimi i vendeve të reja të punës, me theks të veçante për gjininë femërore dhe të rinjë
- Zhvillimi i ndërmarrësisë (zejeve) tradicionale te komunës sonë;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë që kontribuon direkt ne zhvillimin e sektorit të ekonomisë.

### 3. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme indikative për këtë thirrje është 20,000 € Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Grandi do të jepet për:

Projekte biznesi ( mikro ndërmarrje 1-9 punëtor)

Shuma e grantit

Vlera e grandit do të jetë deri në 2,000 €

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantet duhet të jetë 20%. Shuma prej 80% mbulohet nga Autoriteti Kontraktues (Komuna e Rahovecit ).

#### **4. Kualifikimi i aplikanteve: kush mund te aplikojë?**

Për t'u kualifikuar për grand, aplikanti/ja duhet:

- Të jetë shtetas të Kosovës, banor rezident i komunës së Rahovecit (dëshmohet me kopjet e letërnjoftimit),
- Aplikanti i përgjedhur duhet që ligjërisht të themelojë biznesin në komunën e Rahovecit para nënshkrimit të Kontratës së grandit,
- Të jetë drejtëpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit,
- Bizneset e regjistruara duhet që të kanë te shlyera të gjitha obligimet ndaj Komunës së Rahovecit,
- Personat Fizik që aplikojnë të kenë të shlyera obligimet ndaj tatimit në pronë.

#### **5. Aplikantet qe nuk kualifikohen**

Aplikantet potenciale nuk mund te marrin pjesë ne ThPP janë te renditur si ne vijim:

- Është shërbyes civil në ndonjë nga institucionet lokale ose qendrore të Kosovës,
- Është banor nga ndonjë komunë tjeter,
- Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave,
- Kanë pezulluar aktivitetet afariste,

#### **6. Sektorët**

Përmes thirrjes aplikantet duhet të paraqesin **projekt-propozim** për sektorët:

- Përpunimi i metalit
- Përpunim i plastikës
- Përpunimi i drurit
- Arti zanatet

#### **7. Lokacioni**

Projekti duhet të realizohet në territorin e komunës se Rahovecit.

#### **8. Formularët e aplikimit**

Aplikantet duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit duke përdorur formularin e aplikimit të ofruar nga autoriteti kontraktues të bashkangjitur në këtë thirrje .

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

**-Nëse aplikuesi është person fizik:**

- Formulari i aplikimit
- ID e aplikuesit
- Projekt Propozimi
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Konfirmimi për llogari bankare

-Nëse aplikuesi është person juridik:

- Formulari i aplikimit
- Projekt Propozimi
- Certifikata e biznesit (informata për biznesin)
- ID e pronarit
- Vërtetim qe i ka të shlyera obligimet ndaj Komunës se Rahovecit
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së
- Konfirmimin e xhirollogarisë bankare

## **9. Kriteret dhe Vlerësimi**

- Të jetë biznes i regjistruar (aktiv ne ARBK),
- Të ketë të deklaruar së paku 1 punëtor brenda viti 2018 (dëshmi e ATK-së)

Vlerësimi i aplikacioneve do të përfshijë kontrollin administrative, kontrollin e kualifikueshmëris dhe vlerësimin final. Procesi i kontrollit teknik do të vlerësoj nëse aplikuesi ka paraqitur dokumentet e këruara me këtë udhëzues , kontrolli i kualifikueshmëris do të vlerësoj nëse aplikuesi ka respektuar kriteret e kualifikueshmëris dhe vlerësimi final i cili do të vlerësoj në bazë të kritereve për vlerësim. Grandi do ti jepet aplikanteve (me notë më të lartë), deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

## **10. Shpenzimet e pranueshme**

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e THPP llogariten si **shpenzime të kualifikueshme**:

- Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese;

## **11. Mënyra e Aplikimit**

Aplikacioni mund te shkarkohet ne WEB-faqe te Komunës se Rahovecit, ose te tërhiqet ne zyrat e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Aplikacioni i plotësuar duhet dorëzuar ne adresën:

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ,Komuna e Rahovecit

Rr. " Sheh Myhedini" pn.

## **12. Afati për dorëzimin e aplikacionit te plote.**

Afati për dorëzimin e aplikacionit është nga 04 shtator deri me 23 shtator 2019.